



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E
PROJEKTEVE STRATEGJIKE,
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORËS,
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 845 Prot.

Lezhë, më 20/05 /2022

P/VENDIM

Nr. _____ Datë 20/05 /2022

PËR

“LIDHJEN E MARRËVESHJES SË BINJAKËZIMIT NDËRMJET BASHKISË
LEZHË, SHQIPËRI DHE BASHKISË BÜYÜKÇEKMECE, TURQI”

Mbështetur në Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 9, të drejtat dhe përgjegjësitë, pika 1.5. "Të drejtën e bashkëpunimit", paragrafi b) “bashkëpunojme me njësi të vetëqeverisjes vendore të vendeve të tjera dhe perfaqësohen në organizata ndërkombëtare të pushteteve vendore”, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi, si dhe Vendimin Nr 734, datë 9.9.2015 PËR RREGULLIMIN E VEPRIMTARISË ME JASHTË TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE pikat 9 dhe 11 c.

PROPOZOJ:

1. Lidhjen e marrëveshjes së binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Lezhë, Shqipëri dhe Bashkisë Büyükcekmece, Turqi”.
2. Të ngarkohet për të lidhur marrëveshjen e binjakëzimit Kryetari i Bashkisë Lezhë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI
Pjerin NDREU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E
PROJEKTEVE STRATEGJIKE,
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORËS,
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 8457 Prot.

Lezhë, më 10/10/2022

RELACION

PËR
LIDHJEN E MARRËVESHJES SË BINJAKËZIMIT NDËRMJET BASHKISË
LEZHË, SHQIPËRI DHE BASHKISË BÛYÛKÇEKMECE, TURQI

Mbështetur në Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 9, të drejtat dhe përgjegjësitë, pika 1.5. "Të drejtën e bashkëpunimit", paragrafi b) "bashkëpunojme me njësi të vetëqeverisjes vendore të vendeve të tjera dhe perfaqësohen në organizata ndërkombëtare të pushteteve vendore", në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi, si dhe Vendimin Nr 734, datë 9.9.2015 PËR RREGULLIMIN E VEPRIMTARISË ME JASHTË TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE pikat 9 dhe 11/c, Bashkia Lezhë ka shprehur kërkesën për fillimin e një bashkëpunimi me Bashkinë Büyükçekmece me anë të shkresës Nr.12616 Prot., Datë 30.06.2021. Kjo kërkesë është dërguar nga momenti që jemi informuar nepërmjet Konsullës së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Stamboll për interesimin e Bashkisë Büyükçekmece për bashkëpunimin me Bashkinë Lezhë. Bashkia Büyükçekmece me atë të shkresës Nr. 12990., Datë 06.07.2021 është përgjigjur duke qenë e gatshme për fillimin e një bashkëpunimi dhe të një binjakëzimi.

Bashkia Lezhë me shkresën Nr. 15201 Prot., Datë 23.08.2021 i është drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për këshillimin në lidhje me mundësinë e një binjakëzimi ndërmjet dy bashkive. Ministria e Punëve të Jashtme me anë të shkresës Nr. 10479/1., Datë 30.08.2021, protokolluar në Bashkinë Lezhë me nr. 15201/1 Prot., Datë 31.08.2021 është shprehur parimisht dakort për fillimin e procedurave të binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Lezhë dhe Bashkisë Büyükçekmece.

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është të lehtësojë shkëmbimin e ndërsjelltë të përvojave ndërmjet bashkive dhe banorëve të saj, të kuptojë dhe njohë më mirë kulturat dhe zakonet e njëra-tjetrës, të krijojë marrëdhënie miqësore dhe mundësi për bashkëpunim në të ardhmen





në interes të Palëve Kontraktuese. Bashkëpunimi ndërmjet Palëve Kontraktuese do të bazohet në parimin e barazisë duke u fokusuar në fushat me interes të përbashkët.

Bashkëngjitur gjeni draft marrëveshjen.

KRYETARI
Pjerin NDREU





MARRËVESHJE BINJAKËZIMI
Bashkia Büyükçekmece , Republika e Turqisë
&
Bashkia Lezhë, Republika e Shqipërisë

Bashkia Büyükçekmece e përfaqësuar nga Dr. Hasan AKGÜN, Kryetar i Bashkisë
Bashkia Lezhë e përfaqësuar nga z. Pjerin Ndreu, Kryetar i Bashkisë

Parathënie

Bashkia Büyükçekmece dhe Bashkia Lezhë të referuara si Palë Kontraktuese, rikonfirmojnë synimin e tyre të deklaruar më parë për të krijuar një marrëveshje binjakëzimi me njëra-tjetrën bazuar në përfitime reciproke. Qëllimi i kësaj marrëveshje është të lehtësojë shkëmbimin e ndërsjelltë të përvojave ndërmjet bashkive dhe banorëve të saj, të kuptojë dhe njohë më mirë kulturat dhe zakonet e njëra-tjetrës, të krijojë marrëdhënie miqësore dhe mundësi për bashkëpunim në të ardhmen në interes të Palëve Kontraktuese. Bashkëpunimi ndërmjet Palëve Kontraktuese do të bazohet në parimin e barazisë duke u fokusuar në fushat me interes të përbashkët.

1. Korniza kryesore për bashkëpunim

1.1 Palët Kontraktuese deklarojnë se bashkëpunimi i tyre do të vendosë theks të veçantë për:

- të filluar bashkërisht projektet ndërkombëtare.
- të ndërmarrë hapa për zhvillim të qëndrueshëm, një të ardhme të gjelbër dhe mjedis;
- të zbatojë programe kulturore, arsimore dhe sportive;
- të promovojë mundësi të barabarta, siguri sociale, përgjegjësi sociale;
- ndërtimi i partenriteteve ndërmjet sektorit civil, bashkiak dhe korporativ;
- të ndajë njohuritë dhe përvojën e akumuluar deri më tani në fushën e menaxhimit urban dhe dixhitalizimit;

1.2 Palët Kontraktuese do të bien dakord për bashkëpunime, programe dhe ngjarje specifike që do të zbatohen në fushat e përcaktuara në pikën e mësipërme, rast pas rasti dhe me shkrim. Departamentet pjesëmarrëse dhe personat përgjegjës do merren me zbatimin e tyre.



1.3 Për të arritur objektivat e mësipërme, Palët Kontraktuese marrin përsipër:

- të kenë kontakte të rregullta me njëri-tjetrin;
- lehtësimin e kontakteve ndërmjet institucioneve të dy bashkive;
- inkurajimin e kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet organizatave civile dhe sociale dhe ndërmarrjeve ekonomike në të dy rrethet dhe ofrimin e ndihmës për të interesuarit;
- të mbështesë shkëmbimin e përvojës, transferimin dhe shkëmbimin e praktikave të mira.

2. Dispozita të tjera të kontratës kuadër

2.1 Kontrata ekzistuese do të ndërpritet në situatat e mëposhtme:

- Në rast të mos-marrëveshjes së ndërsjelltë të Palëve Kontraktuese;
- Në rast se Palët Kontraktuese e ndërpresin kontratën pa pasardhës,



Palët Kontraktuese bien dakord që kjo marrëveshje mund të përfundojë së bashku dhe me konsensus me një datë të ardhshme të rënë dakord reciprocikisht dhe pëcaktojnë që asnjë pretendim material ose tjetër nuk do të bëhet kundër njëra-tjetrës, si rezultat i një përfundimi të tillë.

2.2 Kjo kontratë kuadër mund të ndërpritet nga secila palë duke i dhënë njoftim me shkrim palës tjetër pa dhënie arsye brenda 90 ditëve.

2.3 Kjo kontratë kuadër mund të ndryshohet me marrëveshje të ndërsjellë të Palëve Kontraktuese në çdo kohë vetëm me shkrim. Në mungesë të një ndryshimi me shkrim, amendamenti është i pavlefshëm dhe nuk mund të prodhojë efekt juridik. Përfundimi i kontratës kuadër nuk do të ndikojë në zbatimin e programeve dhe projekteve në proces sipas një marrëveshje të veçantë ndërmjet Palëve Kontraktuese, përveç rasteve kur Palët Kontraktuese bien dakord ndryshe.

2.4 Kjo Marrëveshje Kuadër do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit dhe do të jetë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare e rinovueshme edhe për 5 (pesë) vite të tjera, përveç nëse specifikohet ndryshe nga njëra palë në deklaratën e saj me shkrim drejtuar palës tjetër 90 ditë para mbarimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit.

2.5 Palët Kontraktuese do të caktojnë departamentet dhe/ose personat e mëposhtë ndërlidhës për qëllimet e kësaj kontrate kuadër:

Për Bashkinë Büyükçekmece, Stamboll:

Njësia organizative / Emri: Director of Foreign Relations/Uğur Şener

Tel: + 90 537 970 29 77

E-mail: dis.iliskiler@bcekmece.bel.tr, ugur.sener@bcekmece.bel.tr

Për Bashkinë Lezhë:

Njësia organizative/ Emri: Drejtor Drejtorja e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës/ Elson Frroku

Tel: +355694305085

E-mail: elsonfrroku@gmail.com; projekte.strategjike@bashkialezhe.gov.al

2.6 Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë në mirëbesim në përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas kësaj Marrëveshjeje Kuadër në mënyrën që pritet prej tyre.

2.7 Palët Kontraktuese bien dakord që kostot e shkaktuara në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të përballohen nga secila palë. Në lidhje me këto asnjë pretendim apo kërkesë nuk bëhet ndaj njëri-tjetrit.

2.8 Kjo Marrëveshje Kuadër është hartuar në Shqip, Anglisht dhe Turqisht 2 (dy) kopje identike me njëra-tjetrën, nga të cilat 1-1 kopje i përket Palëve Kontraktuese. Kjo Marrëveshje Kuadër miratohet në emër të Palëve Kontraktuese në përputhje me dëshirat e tyre.

Nënshkrimi

Z. Hasan AKGÜN

Kryetar

Bashkia Büyükçekmece / Turqi

Z. Pjerin Ndreu

Kryetar

Bashkia Lezhë / Shqipëri

